



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 2564 Prot.

Klos, më 15.09 /2023

P/VENDIM

NR. _____ datë ___/___/2023

“Për miratim fondi financiar për blerje automjeti për përdorim të veçantë, për përballimin e situatave emergjente të krijuar si pasojë e një fatkeqësie”

Në mbështetje të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015, “Për vetqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 45 datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile” dhe VKM nr. 290 datë 17.05.2023, për një ndryshim në vendimin nr. 414 datë 08.07.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe të kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile shkronja “ë”, e pikës 3.1 ndryshohet: “Blerjen e automjetëve për përdorim të veçantë, makinave teknologjike dhe mjeteve rrugore të veçanta, të përcaktuara si të tilla, sipas parashikimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente, të krijuara si pasojë e një fatkeqësie, si dhe për shpenzime të kryera për blerje karburanti dhe pjesës ndërrimi për automjete dhe makineri, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente, të krijuara si pasojë e një fatkeqësie.” dhe në V.K. Bashkisë nr. 82 datë 21.12.2022 (Buxheti i vitit 2023), i propozojmë Këshillit të Bashkisë të

V E N D O S Ë:

- I. Të miratojë shumën 2458410 (dy milionë e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dhjetë) lek të Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Emergjencat Civile të Bashkisë, me kod produkti 2458410, për blerjen e një automjeti për përdorim të veçantë, tip Fadrom, për përballimin e situatave emergjente të krijuara nga fatkeqësi.

- II. Pas konfirmimit të Vendimit, për bazueshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Dibër, ngarkohen strukturat përgjegjëse të Bashkisë për zbatimin e tij.

KRYETARI I BASHKISË

Valbona KOLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. ____ Prot.

Klos, më ____ / ____ /2023

LENDA: Relacion shpjegues.

DREJTUAR: Këshillit të Bashkisë

Klos

Të nderuar Këshilltarë!

Sipas ligjit 139/2015, Bashkia është përgjegjëse për Mbrojtjen Civile dhe administrimin e strukturave përkatëse, garantimin e shërbimit zjarrfikës, administrimin e fondit pyjor, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit. Menaxhimi i një fatkeqësie natyrore kërkon bashkëpunim organik të aktorëve dhe faktorëve që kanë lidhje me emergjencat civile. Ndër masat e marra për zvogëlimin e rrishtit është dhe gadishmëria e strukturave përgjegjëse dhe mjetëve motorike për të hyrë në veprim në kohën e duhur. Numri i mjetëve për përdorim të veçantë në rast fatkeqësie është i pakët. Gjendja teknike e këtyre mjeteve është në nivelet disi mirë. Mjetet motorike të rënda të Bashkisë janë me shumë vite punë. Ata kanë kosto të lartë përdorimi. Rrëshqitjet masive të tokës daljet nga shtretërit i përrenjëve, gjatë stinëve me reshje shoqërohen me rënie gurësh e inertesh, bllokime nga bora në segmente të rrugëve nacionale e rurale, duke prishur ekuilibrin e jetës të komunitetit dhe çënuar lëvizjen normale të njerëzëve dhe mjeteve. Terreni kodrinor-malor, mungesa e koridoreve në parcelat e pyjeve të ulta dhe ata të larta vështirësojnë misionet e shërbimit zjarrfikës, në rastet e zjarreve masive, duke rritur shumë rrishtin negativ të dëmeve. Më të ekspozuara për tu prekur nga këta fatkeqësi janë fshatrat malor të Njërive Administrative Xibër, Gurrë dhe Suç. Gjatë 2 viteve të fundit fatkeqësitë e ndodhura i kemi përballuar me fuqinë njerëzore e mjetet motorike të Bashkisë, duke kërkuar mbështetje firmave private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territor dhe duke marrë mjete të rënda me qira.

Eshtë më se e domosdoshme, sikurse kemi në gadishmëri mjetet zjarrfikëse 24/7 të kemi dhe borëpastruese e fadroma në gjendje pune. Duke qenë se Qeveria ka alokuar një fond financiar të veçantë për emergjencat civile në Bashki dhe VKM nr. 414 datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile" dhe VKM nr. 290 datë 17.05.2023, për një ndryshim në vendimin nr. 414 datë 08.07.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurave dhe të kriterëve

të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile shkronja “ë”, e pikës 3.1 ndryshohet: “Blerjen e automjetëve për përdorim të veçantë, makinave teknologjike dhe mjeteve rrugore të veçanta, të përcaktuara si të tilla, sipas parashikimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente, të krijuara si pasojë e një fatkeqësie, si dhe për shpenzime të kryera për blerje karburanti dhe pjesë ndërrimi për automjete dhe makineri, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente, të krijuara si pasojë e një fatkeqësie” e lejon mundësinë e përdorimit të këtij fondi për blerjen e një mjeti për përdorim të veçantë. Prandaj ju propozojmë të miratoni shumën 2458410 (dy milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dhjetë) lek, me kod produkti 24 58410 të Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Emergjecat Civile të Bashkisë Klos për blerjen e një automjeti tip Fadrom, në mbështetje të përballimit e situatave emergjente që mund të krijohen nga fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria e njeriut Mjeti tip-Fadromë të përdoret për përballimin e situatave emergjente gjatë stinëve Dimër-Pranverë 2023-2024.

P.Z.E.Civile:

Nerim Dema



Nënkryetari i Bashkisë:

Bashkim Dardha

